



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.5.2023

Nr: 512

Ora: 16:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 434, NGA ZJ. ALBANA VOKSHI PËR
NDALIMIN E TRANSMETIMIT TË MATERIALIT REKLAMUES NË EKTRANIN LED NGA SUBJEKTI
ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", BASHKIA LUSHNJË, PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 13 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

KËRKUES: Zj. Albana Vokshi

OBJEKTI: Kërkohe marrja e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për ndalimin e transmetimit të materialit reklamues në ekranin LED nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", Bashkia Lushnjë.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", e pika 2, si dhe neni 79, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me denoncues Zj. Albana Vokshi. Denoncimi është regjistruar me nr. 434 ID, datë 13.5.2023, të regjistrit të denoncimeve. Nëpërmjet këtij denoncimi pretendohet se: "Në ditën përpara datës së zgjedhjeve në lagjen "Çlirimi", pranë "Metropol Center", është afishuar reklamë zgjedhore

Data: 13.5.2023 Nr: 512
Ora: 16:30



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 434, nga zj. Albana Vokshi për ndalimin e transmetimit të materialit reklamues në ekranin LED nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", Bashkia Lushnjë, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023"

(billborder) në mbështetje të kandidatës për Bashkinë Lushnjë, të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Pala kërkuese kërkon marrjen e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore, lidhur me veprimet e kryera, sipas provave të paraqitura bashkëlidhur.

Nga analiza ligjore, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi, vlerësojmë se reklama zgjedhore (billborder) nuk përmban shënimin “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor), duke qenë në kundërshtim të nenit 79, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, si dhe nenin 79, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë Bashkiake Lushnjë dhe Policisë së Shtetit për ndalimin e transmetimit menjëherë të materialeve reklamuese (propagandistike) të shfaqura në ekranin led në lagjen “Çlirimi”, pranë “Metropol Center”, Bashkia Lushnjë.
2. Ngarkohen subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Lushnjë për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
3. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Lushnjë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI